



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 25.11.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022 e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 24.11.2025, të parashtruar nga Operatori Ekonomik 24.112025, të parashtruar nga Operatori Ekonomik CPS Phoenix Group L.L.C., lidhur me aktivitetin e prokurimit "Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Gjakovës", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-25-10198- 2-1-1, Nr. i brendshëm-632-25-124-211, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit ekonomik CPS Phoenix Group L.L.C. , e dt.24.11.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Gjakovës", Nr. i prokurimit- 632-25-10198- 2-1-1, Nr. i brendshëm- 632-25-124-211, kundër DOSJES SË TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, të datës 11.11.2025, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Vërtetohet DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË**, të publikuar me datë: 11.11.2025;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

Arsyetim

Operatori ekonomik CPS Phoenix Group L.L.C., me dt.24.11.2025, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Gjakovës", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-25-10198- 2-1-1, Nr. i brendshëm-632-25-124-211.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 25.11.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj i parë nuk qëndron, sepse çdo kompani fituese duhet të ketë një bashkëpunim me ndonjë institucionin trajnues me qëllim që secili i punësuar të trajtohet menjëherë për shkak të respektimit të ligjit për kompanitë private të sigurimit dhe kjo kërkesë nuk është diskriminuese duke pasqyruar se ka të beje pikërisht me industrinë e sigurimit fizik, dhe një memorandum i tillë mund të arrihet lehtë me institucionin e lartë cekur.

Pretendimi juaj i dytë nuk qëndron, sepse për këtë pikë kemi dhënë edhe një sqarim me herët në kërkesën për sqarim tenderi andaj mbetet kërkesa e tillë siç është sepse ne si Autoritet Kontraktues, konsiderojmë se për shkak të rëndësisë së shërbimeve të cilat do të kryhen në objektet e Komunës së Gjakovës, është shumë me rëndësi që shërbimet të udhëheqen nga një menaxher i cili ka provojë pune dhe arsim të lartë.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi të këtij vendimi.

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;